



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 67, datë 02.10.2018

**PËR SHITESË FONDI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 02.10.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 35 pika 1 shkronja “d”, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 20 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat statndarte të zbatimit të buxhetit, udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.1.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, udhëzimit nr. 8, datë 17.2.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donator të huaj, VKM nr. 533, datë 4.10.2017 “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, për programin Interreg V-B Adriatiko-Jonian (Adrion) 2014-2020”, ligjin nr. 21/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Europian për programin Interreg V-B Adriatiko-Jonian (Adrion) 2014-2020”, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2018-2020 të bashkisë Shkodër”,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shtesës së fondit (planit) në buxhetin e bashkisë Shkodër me burim financimi donacion në llogari jashtë llogarive të thesarit në programin 10430 “përkujdesi social”, zëri “shërbime kapitale të pa trupëzuara”, në shumën **51,429.25 Euro** (*pesëdhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e nëntë pikë njëzet e pesë*), konvertuar në lek sipas kursit të këmbimit të ditës që do të transferohet fondi, me burim financimi: EU programi INTERREG V-B Adriatico-Jonian 2014-2020 (ADRION).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 2.10.2018

Shpallur në datën 8.10.2018

**Sekretar i këshillit**



**Suel Hadri**

**KRYETAR**



**Xhemal BUSHATI**

P/c 17461 22.10.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT SHKODER  
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 1234/1 prot

Shkodër, më 18.10.2018

**LËNDA: Lidhur me vendimin nr. 67, datë 02.10.2018 të Këshillit Bashkiak Shkodër**

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin", neni 8, gërma a, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35, pika 1. shkronja d. neni 36, pika 2, neni 54, pika dh, neni 55 pika 3, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 20, të ligjit nr. 9963. datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", pika 190, të Udhëzimit MF nr. 8, dt. 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrveshjeve me donator të huaj", të VKM nr. 533, dt. 04.10.2017 "Për miratimin, në parim, të marrveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, për programin Interreg V-B Adriatiko-Jonian (Adrion) 2014-2020", të ligjit nr. 21/2018 "Për ratifikimin e marrveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, për programin Interreg V-B Adriatiko-Jonian (Adrion) 2014-2020", të VKB nr. 85, datë 26.12.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2018-2020", shqyrtoi **VKB Shkodër nr. 67, datë 02.10.2018 "Për shtesën e fondit prej 51,429.25 euro, në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB Shkodër 85/2017, në prog. 10430/përkujdesi social, me burim financimi ADRION" (EU program INTERREG V-B Adriatiko-Ionian 2014-2020)**".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedimin e mëtejshëm.

Me respekt,

**PREFEKTI**

Çesk MILLJA

